



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 416 Akti

Nr. 492 Vendimi
Tiranë, më 21.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 20.12.2021, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Shkëlqim Miri**, ish-gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi rimori në analizë çështjen që i përket subjektit Shkëlqim Miri, dëgjoi relatoren e çështjes, komisioneren Suela Zhegu, e cila relatoi mbi çështjen në tërësi në përputhje me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimin me nr. 29 (JR), datë 7.10.2021, shqyrtoi gjatë situatën e krijuar nga mungesa në këtë vendim të Kolegjit e një pike të veçantë orientuese për përfundimin e këtij procesi nga Komisioni, dhe përfundimisht, u dakordësua të përfundojë çështjen objekt shqyrtimi, si dhe bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave sipas pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Shkëlqim Miri është subjekt rivlerësimi për shkak të detyrës si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, pasi u përzgjedh me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” (në vijim Komisioni).

3. Referuar nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin ka filluar menjëherë me caktimin me short të trupit gjykues të përbërë nga komisionere Suela Zhegu, me cilësinë e relatores, dhe me cilësinë e anëtarit komisionerët Firdes Shuli dhe Brunilda Bekteshi.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave sipas neneve 31-33, të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016.

5. Trupi gjykues, në mbledhjen e datës 18.12.2019, ka caktuar me mirëkuptim kryesuesen e trupit gjykues komisionere Firdes Shuli, si dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga secili prej anëtarëve të këtij trupi.

6. Relatori i çështjes, në bazë të neneve 33 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e përpiluara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK).

7. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijon:

- a. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, në DSIK, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

8. Komisioni, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri, me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2021, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2021, ka dërguar dokumentacion të plotë, ndër të tjera, edhe vendimin nr. ***, datë 27.10.2020, të

KLJGJ-së, mbi shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Shkëlqim Miri, për shkak se është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

10. KLJGJ-ja, bazuar në pikën 2, të nenit 140, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar se vendimi nr. **, datë 27.2.2019, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 27.11.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, e ka konsideruar fajtor dhe e ka dënuar gjyqtarin Shkëlqim Miri¹.

11. Ky vendim është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për t’u zbatuar.

11.1 Vepra penale e korrupsionit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të drejtësisë, për të cilën është dënuar gjyqtari, cilësohet nga Kodi Penal si një krim, të cilit i korrespondojnë edhe masat disiplinore.

12. KLJGJ-ja, pasi ka evidentuar se vendimi penal i dënimit ka marrë formë të prerë dhe, si rrjedhojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e “shkarkimit nga detyra” për gjyqtarin Shkëlqim Miri, parashikuar nga germa “b”, e pikës 2, të nenit 140, të Kushtetutës dhe neni 111 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak se është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

13. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pikën 2/b të nenit 140, përcakton në mënyrë taksative se gjyqtari shkarkohet nga detyra, ndër të tjera, edhe kur është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

14. Gjykata Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021, ka informuar se në regjistrin e çështjeve për ankimet, në kuadër të juridiksionit Disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nuk është regjistruar ankim nga z. Shkëlqim Miri, kundër vendimit nr. ***, datë 27.10.2020, të KLJGJ-së.

15. Në kushtet kur “shkarkimi nga funksioni për përgjegjësi disiplinore” përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të germës “ç”, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në parashikimet e kësaj dispozite ligjore.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

17. Trupi gjykues konstaton se z. Shkëlqim Miri ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

18. Bazuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në referim të germës “ç”, të pikës 1, të nenit 64, ndër të tjera, përcaktohet se: “*Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni*”.

¹Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, me vendimin nr. **, datë 27.2.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. **, datë 27.11.2018, të Gjykatës për Krime të Rënda, në lidhje me masën e dënimit për të pandehurin Shkëlqim Miri, duke e dënuar atë me 3 vjet burgim, nga 3 vjet e 9 muaj.

19. Trupi gjykues, pasi u njoh me vendimin nr. ***, datë 27.10.2020, të KLGj-së, për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Shkëlqim Miri, për shkak të një dënimi penal të formës së prerë, si dhe me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm të Apelimit, ku informohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 27.10.2020, të KLGJ-së, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Shkëlqim Miri është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak se është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Në këto kushte, subjekti ka humbur statusin e magjistratit.

20. Trupi gjykues ka arritur në përfundimin se mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative, pa një vendim përfundimtar, mbështetur kjo në nenin 95² të Kodit të Procedurave Administrative.

21. Përfundimisht, për faktin që subjekti i rivlerësimit nuk gëzon statusin e magjistratit, trupi gjykues vlerësoi të përfundojë procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Shkëlqim Miri.

22. Komisioni, me vendimin nr. 374, datë 23.4.2021, për subjektin Shkëlqim Miri ka vendosur: *“Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit, pasi është dënuar me vendim penal të formës së prerë”*.

23. Komisioneri Publik ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka kërkuar *ndryshimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit, duke e kategorizuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri, si çështje të papërfunduar, për efekt të juridiksionit të rivlerësimit.*

24. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me vendimin nr. 29 (JR), datë 7.10.2021, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Miri, duke arsyetuar se në kuptim të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni, në të tilla rrethana faktike, duhet të deklarojë të përfunduar procedurën administrative, pa një vendim përfundimtar, me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit e ka humbur statusin e magjistratit për shkak të shkarkimit nga detyra me vendim të KLGJ-së.

25. Përfundimisht, trupi gjykues, në përputhje me vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ka reflektuar ndryshimet përkatëse.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2/b, të nenit 140, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.

²Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.

2. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 21.12.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Brunilda BEKTESHI

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha